

Ekosistemi i Ligatinës në Henc / Radevë, mundësitë e menaxhimit të qëndrueshëm të sajë

MSc. Ylber Sherifi

PËRMBLEDHJE

Ekosistemet ujore në Kosovë janë të përfaqësuara me një gamë të llojeve të ligatinave të tilla si liqenet akullnajore dhe livadhe me lagështi, burime ujore, përrenj, lumenj, rezervuare artificiale të ujit, hurdha të peshqve, dhe pellgje të përkohshme.

Megjithëse një inventar i plotë i ligatinave ende nuk është kryer në Kosovë, një nga ligatinat më të rëndësishme është ajo e Hencit / Radevë, e cila shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës. Me sipërfaqe prej 74 ha. Ajo është krijuar në mënyrë artificiale në fund të viteve të 60 për qëllim të kultivimit të krapit (*Cyprinus carpio*). Ligatina është krijuar nga bashkimi i ujërrjedhave të Magures dhe Vrellës, të cilat janë degë të lumit Sitnicë. Në bazë të të dhënave, ajo ka arrit një suksesion të plotë të karakterit të ligatinës natyrore.

Ky punim paraqet të gjeturat e para shkencore për biodiversitetin e ligatinave në Kosovë. Gjatë këtij hulumtimi janë regjistruar, 41 lloje të shpendëve, 4 lloje të peshqve, 3 lloje të reptilëve, 2 lloje të amfibëve, 2 lloje të gjitarëve, 8 lloje të pilivesave nga rendi Odonata dhe 28 lloje të bimëve.

Ky hulumtim mund ti paraprijë edhe shpalljes së kësaj ligatinë si zonë ligatinore e mbrojtur sipas ligjeve kombëtare dhe njëherazi mund të propozohet si Zonë e Rëndësishme për Shpendët (IBA) për Kosovën. Kjo do të bënte të mundur ruajtjen dhe menaxhimin e saj të qëndrueshëm sipas kërkesave të konventës RAMSAR.

Menaxhimi i qëndrueshëm i kësaj zone mund të ofrojë mundësinë edhe për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe rekreative siç është vërtetimi i shpendëve, peshkimi, çlodhja që mund të ofrojë kënaqësi për shumë vizitorë dhe mund të sjellë përfitime ekonomike.

SUMMARY

Water ecosystems in Kosovo are represented with by a range of wetland types such as glacier lakes and wet meadows, springs, streams, rivers, artificial water reservoirs, fish ponds, and temporary ponds. However, a full inventory of wetlands is not yet conducted in Kosovo. One of the most important wetland located in the central part of Kosovo is the wetland site of Hencit / Radevë. With the surface of 74 ha, it was artificially created in the late sixties, aiming cultivation of the common carp (*Cyprinus carpio*). This wetland was created by the conflux of Magura and Vrella water flows, which are branches of Sitnica River.

Due to the ecological processes, this wetland is turned out into a naturally evolving ecosystem. This paper represents the first scientific findings about wetland biodiversity in Kosova. During this research, 41 species of birds, 4 species of fish, 3 species of reptiles, 2 amphibians, 2 mammals, 8 insect of the order Odonata and 28 species of vascular plants are registered.

This research may also precede the declaration of this wetland as a protected area under national Law, and at the same time can be proposed as Important Bird Area (IBA) for Kosovo. This will enable its preservation and the sustainable management in compliance with Ramsar Convention requirements.

Sustainable management of this wetland site may provide the opportunity for development of sports and recreational activities, such as birdwatching, sport fishing, rest that can provide enjoyment for many visitors and can bring economic benefits.